



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPSHTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 12.2 pika, nenit 16 ,17 c), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, Ligjit Nr. 07/I-001 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, Ligjit 02/L-109 për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi si dhe nenit 20 paragrafi.1 të Statutit të Komunës së Lipjanit, INr.110-623 të datës 26.09.2008 Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me 28. 05. 2020, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës miratoi këtë:

VENDIM

PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR PUNËTORËT E KOMUNËS SË LIPJANIT QË KANË PUNUAR NË TEREN GJATË PANDEMIS COVID - 19

Neni 1.

NDAHET, shuma e mjeteve financiare në vlerë prej 12,600.00 €(dymbëdhjetë mijë e gjashtëqind euro) për pagesën e puntorëve të Komunës së Lipjanit, të cilët kanë punuar për menaxhimin e situatës dhe shpërndarjen e ndihmave të ndryshme për familjet në nevojë dhe janë ekspozuar rrezikut të drejtëpërdrejt në teren nga pandemia COVID -19, puntorët që kanë punuar në teren, që do të ju ndahet shuma në vlerë prej 300 € (treqind euro) për muaj, janë punëtorët si në vijim:

1. Albert Mustafa, Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale
2. Lorik Bërbatovci, Qendra për Punë Sociale
3. Behar Amerllahu, Qendra për Punë Sociale
4. Fjolla Ibrahim, Qendra për Punë Sociale
5. Venera Jashanica, Qendra për Punë Sociale
6. Shefki Sadiku, Drejtorati për Administratë
7. Rrahim Krasniqi, Drejtorati për Administratë
8. Behar Aliu, Drejtorati për Administratë
9. Ukshin Shahini, Zyra e Kryetarit të Komunës
10. Islam Kaleshi, Zyra e Kryetarit të Komunës
11. Gafurr Hetemi, Zyra e Kryetarit të Komunës
12. Besart Troshupa, Zyra e Kryetarit të Komunës
13. Regjep Zejnnullahu, Drejtorati i Prokurimit
14. Arben Bahtiri, Drejtorati për Arsim
15. Ismet Haziri, Drejtorati për Arsim
16. Ismet Ahmeti, Drejtorati për Arsim
17. Bashkim Hyseni, Drejtorati për Arsim
18. Smajl Shabani, Drejtorati për Arsim
19. Islam Sylejmani, Drejtorati për Kultur, Rini dhe Sport
20. Valdet Zejnnullahu, Kryqi i Kuq Lipjan
21. Fatime Bërbatovci, Kryqi i Kuq Lipjan

Neni 2

Shuma e mjeteve të cekura më lartë do të ndahet nga Kategoria e mallrave dhe shërbimeve të planifikuara për Drejtoratin për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale për vitin 2020, të cilat ju ndahen punëtorëve të cekur në nenin 1 të këtij Propozim Vendimi (për dy muaj Mars dhe Prill), të cilat mjete janë të planifikuara sipas Vendimit të Kuvendit të Komunës 15Nr.400-16849 të datës 17.04.2020, për menaxhimin e situatës emergjente nga pandemia COVID-19.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa dhe Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.

Neni 4.

Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës.

15 Nr. 400-19921

Lipjan, më 29. 05. 2020

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi

